

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"FROM ZERO COMPANY" SHPK

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

a. Sot në Tiranë në datën 15 Shtator 2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "**FROM ZERO COMPANY**" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**FROM ZERO COMPANY**" shpk, formohet nga ortakët themelues:

1. **Mohamed Ahmed**, shtetas egiptian, i datëlindjes 20.08.1986, lindur në Egjipt dhe banues në Cerrik, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr **pasaporte: A26914738**.
 2. **Gazi MD Zahirul Islam**, shtetas bangladeshas, i datëlindjes 31.12.1970, lindur në Bangladesh dhe banues në Bangladesh madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr **pasaporte: BD00060177**.
 3. **Abdulaziz A A A S AlObaid**, shtetas kuvajtian, i datëlindjes 21.05.1982, lindur në Kuvajt dhe banues në Kuvajt, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr **pasaporte: P05733356**.
 4. **Mohammad Kanaan**, shtetas turk, i datëlindjes 01.01.1988, lindur në Siri dhe banues në Turqi, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr **pasaporte: U21024964**.
 5. **Noran Al Kari**, shtetase Siriane, e datëlindjes 01.06.1994, lindur në Siri dhe banues në Siri, madhor eme zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr **pasaporte: N015321838**
- b. Te cilet me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.
- c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare "**FROM ZERO COMPANY**" shpk, fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë.

FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË



Neni 2

1. Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
2. Emërtimi i Shoqërisë është: "**FROM ZERO COMPANY**" shpk.
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 3

1. Shoqëria tregtare "**FROM ZERO COMPANY**" shpk, ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranes, **Rruga "Myslym Shyri"**, Zk 8250, Nr Pasurie 3/178+2-25, Vol 15, Faqe 2378.



- Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqesimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.
- Shoqëria do të ketë vulën e saj.

KOHËZGJATJA

Neni 4

- Shoqëria Tregtare "FROM ZERO COMPANY "shpk, do të përbushë objektin e veprimitarisë së saj me një afat të pacaktuar.
- Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Objekti i shoqerise "FROM ZERO COMPANY " shpk do të jetë:

- Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni i njësive të ndryshme me funksion shërbimesh, banimi apo turizmi. Ndërtimi dhe rikonstruksioni i objekteve, banesave kolektive dhe individuale, apartamenteve dhe vilave individuale. Ndertimi, projektimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e kanaleve kulluese, vaditëse etj. me qëllim bujqesor, industrial, civil etj. Ndertimi, projektimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e rrugëve kryesore e sekondare etj. Menaxhimi i pronave te veta dhe apo i pronave te paleve te treta te huaj apo vendas. Import-eksport dhe tregtim i artikujve te ndryshem, industriale, mirembajtja, shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te pare per industrine, materiale ndertimi e hidrosanitare, pajisje zyrash, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike, autovetura etj. Shitja, blerja, dhenia apo marrja me qira e pasurive te paluajtshme. Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi. Sektori i naftes dhe ngritja e rafinerive. Sektori i mjedisit dhe energjise alternative. Ndertimi dhe funksionimi i termocentraleve. Sektori i infrastructures. Sektori i turizmit dhe ngritja e fshatrave turistike. Pergatitja e studimeve te fizibilitetit per projekte ekonomike dhe investuese. Prodhimi i gazit natyror nga mbetjet. Energjia diellore (ndertim-funksionim - Shitje).

TË DREJTAT E SHOQËRISË

Neni 6

Shoqeria tregtare "FROM ZERO COMPANY "shpk, nuk perjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimitaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne në menyre të pavarur prej saj.

Shoqeria mund të ndryshoje emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimitarisë, administratorin, sipas vendimeve qe do të marrin ortakët.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 000 lekë (Njeqinde mijë leke) , i cili është têrësisht kapital financiar . Kapitali themeltar është i ndarë në 4 (kater) kuota, me vlerë nominale 100 000 lekë (Nje qind mijë leke) e cila zoterohet nga ortaket si me posht:

1. **Mohamed Ahmed**, zotérues i 1 (një) kuote apo 60 % tê kapitalit tê shoqërisë.
2. **Gazi MD Zahirul Islam**, zotérues i 1 (një) kuote apo 10 % tê kapitalit tê shoqërisë.
3. **Abdulaziz A A A S AlObaid**, zotérues i 1 (një) kuote apo 10 % tê kapitalit tê shoqërisë.
4. **Mohammad Kanaan**, zotérues i 1 (një) kuote apo 10 % tê kapitalit tê shoqërisë.
5. **Noran Al Kari**, zotérues i 1 (një) kuote apo 10 % tê kapitalit tê shoqërisë

Ortaket kanë tê drejtë tê tjetersojne, tê zmadhojne apo tê pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji

Kapitali fillestare nuk është paguar.

NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde tê tjera tê veçanta tê financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit tê shoqerise, fondet e krijimit tê saj si dhe perdonimi e rregullimi i çdo fondi tê veçante percaktohen nga Ortaket sipas tê drejtave dhe detyrave tê percaktuara në statut.
2. Të ardhurat e per gjitheshme tê shoqerise dhe në per gjithesi çdo operacion financiar i saj do tê pasqyrohet në kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbeshtetje tê akteve perkatese tê rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria Tregetare "**FROM ZERO COMPANY**" shpk, eshte pronare e pasurise së saj tê cilën e perdon dhe e disponon në emer tê saj në perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise së shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire tê bleje dhe tê shfrytezoje tê drejta tê tjera materiale në perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen në monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do tê mbylljet me 31 Dhjetor tê çdo viti dhe bilanci do tê miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta tê hartuara nga Ortaket dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim tê Ortakeve tê saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht tê transferueshme në rrugë trashegimie. Ato janë lirisht tê transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjesëve tê kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfittues do tê behet pasi ata tê pranojnë permbytjen e statutit tê kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund tê kete pesuar deri në momentin qe keto pjesë tê kapitalit themeltar behen tê transferueshme.

NENI 14


Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave tê trete qe nuk bajne pjesë në shoqeri vetem me miratimin e Ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributave në para dhe në natyre apo zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakeve tê shoqerise mbi bazen e një projekti tê paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTË ORTAKËRIA

NENI 16



Ortakët e shoqërisë tregtare "FROM ZERO COMPANY " shpk, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqiperise, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqerise.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve

NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

KREU I TRETË
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Mohamed Ahmed** i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formen e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

ASAMBLEJA

NENI 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zgjelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT
NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike ;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;



3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblene e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

NENI 22

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licensuar dhe kur kërcohët nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, térheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njofuar organet e Punës së Juridiksonit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

FORCAT MADHORE

NENI 25

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftesi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmanget me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësojnë detyrimet e tij për arsyen e forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkaku.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negativ(Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyen e tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose më shume likujdatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likujdimit emërtimi i shoqërisë do të shoqérohet nga shënim ” Shoqëri në likujdim ”.

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare e Biznesit.

BAZA LIGJORE

Neni 27

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

RUAJTJA E SEKRETIT
Neni 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TË FUNDIT
NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 30


Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqerisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë.

NENI 31

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKET:

Mohamed Ahmed



Gazi MD Zahirul Islam



Abdulaziz A A A S AlObaid



Mohammad Kanaan



Noran Al Kari

